

Lufta kundër pastrimit të parave në Shqipëri

– Roli i shoqërisë civile

RAPORT AKTIVITETI | 25 qershor 2021

Sipas raportit të *Moneyval* të vitit 2018, i cili ekzaminoi standardet e Task Forcës për Aktet Financiare (FATF), pastrimi i parave është kthyer në një çështje shqetësuese në Shqipëri. Gjetjet negative të raportit çuan në një shtim të mekanizmave monitorues – duke e vendosur kështu Shqipërinë në listën e vendeve me rrezikshmëri të lartë. Për të luftuar dhe parandaluar pastrimin e parave, autoritetet shtetërore po forcojnë kapacitetet institucionale, instrumentet legislative, bashkëpunimin midis agjencive dhe burime të tjera për të trajtuar fenomenin.

Në këtë kontekst për të rritur ndërgjegjësimin dhe llogaridhënien, Insituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) mbajti një event, duke mbledhur përfaqësues të shoqërisë civile, medias dhe akademisë. Në fjalën e tij hapëse, Drejtori Ekzekutiv i IDM, Z. Sotiraq Hroni, theksoi se një bashkëpunim i rritur midis aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë është vendimtar në luftën kundër

pastrimit të parave. nëpërmjet nismave hulumtuese.

Përpjekjet për bashkëpunim ndonjëherë mund të pengohen nga hezitimi, pasiguritë e së shkuarës, qasja menaxhuese, dhe kultura politike që i ndalon palët e interesit për të forcuar bashkëpunimin. Megjithatë, është e rëndësishme të vihet re se përfaqësuesit e institucioneve kyç në LKPP që IDM intervistoi në këtë kontekst – e mirëpritën nismën tonë, duke pohuar gatishmërinë e tyre për të marrë kontribute nga aktorë jo shtetërorë dhe për të punuar bashkarisht mbi prioritetet e LKPP në të ardhmen.

Sotiraq Hroni
Drejtor Ekzekutiv, IDM

Ekspertët që morën pjesë në Forumin e parë të IDM mbi LKPP (Luftën Kundër Pastrimit të Parave) më 25 qershor, konfirmuan se kontributi i shoqërisë civile dhe gazetarisë investigative ndihmon në

përshejtimin e procesit të implementimit të rekomandimeve KPP. Z. Gjergji Vurmo, Drejtor i Programit në IDM, theksoi se përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë do të ndihmonte gjithashtu në përmirësimin e llogaridhënies publike, shtuar plotësimin të përpjekjeve institucionale. Specifikisht, kontributi i tyre do të ishte më i vlefshëm në të ndihmuarit për avancimin e rekomandimeve të FATF, të cilat kanë si synim të forcojnë efektivitetin e mekanizmave të AML/CFT^[1] sipas të cilave Shqipëria duhet të punojë mbi reduktimin e ekonomisë jo formale përmes qarkullimit të parasë.

Në vijim të rekomandimeve të FATF të 8-të, të cilat kanë si qëllim përmirësimin e strukturës rregulluese që ndalon keqpërdorimin e organizatave të shoqërisë civile për financimin e terrorizmit, konceptet si KPP dhe KFT gradualisht u bënë më familjare për organizatat e shoqërisë civile shqiptare.

Në këtë kontekst, parlamenti shqiptar miratoi një ligj të ri mbi krijimin e një regjistri të pronarëve përfitues për organizatat jo qeveritare “për shkak të detyrimeve që vijnë nga Moneyval”^[2] dhe raportit të Komisionit European të vitit 2020. Ligji u përball me kundërshtime të forta nga organizatat jo qeveritare meqenjtë që ai u miratua nga parlamenti më 24 qershor 2021. Ekspertët e IDMT-ja në ndërkohë që vëzhgimi financiar i shoqërisë civile ka si qëllim të reduktojë faktorin e rrisjes dhe të rrisë transparencën në luftën kundër pastrimit të parave, shoqëria civile shqiptare ka një rol tejet të

rëndësishëm për të luajtur. Z. Vurmo theksoi se shoqëria civile dhe akademia i kanë zhvilluar tashmë kapacitetet dhe iniciativat që kanë si qëllim të kontribuojnë drejt ekspozimit të mekanizmave dhe të dhënave mbi çështje rreth pastrimit të parave – specifikisht, krimi i organizuar, korrupsioni, korrupsioni politik duke influencuar vendimet politike, VERLT^[3], etj.

Inkurajimi kryesor nga BE tani është për shoqërinë civile Shqiptare dhe qeverinë, që ato të përfshihen në implementimin e përbashkët të akteve nënligjore të Planit të Veprimit FATF.

Aurélien Juliard
Delegacioni i BE në Shqipëri

Si një shtet kandidat për në BE, Shqipërisë i parashtrahet një sfidë e dyfishtë: fillimisht implementimi i rekomandimeve të FATF, dhe pas hapjes së negociatave të aksesimit, Shqipëria duhet të harmonizojë legjislaturën e saj me Acquis-in e BE-së. “Shqipëria është përkohësisht në rrugën e duhur, duke ndjekur Planin e Veprimit FATF, i cili duhet të implementohet deri në shkurt 2022,” tha përfaqësuesi i BE-së, Juliard. Shtuar standardeve të FATF, perspektiva e BE-së është ta cojë legjislaturën e saj në të njëjtën nivel me të FATF. Në përfundim të një legjislature të fortë dhe të unifikuar brenda BE-së, vendet me mekanizmat AML-tanë më të mirë të kapaciteteve dhe ndërvprimeve efikase përmes spektrit të gjerë ekspozuar ndaj qarkullimit financiar të jashtëligjshëm dhe pastrimit të parave. Për këtë arsye, BE ka si qëllim të kundërshtojë cenueshërinë e sektorit financiar dhe të ruajë integritetin e tregut



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në vitin 2005, me qëllim të promovimit të demokracisë së vetëqeverisur, procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Në synojmë konsolidimin e zhvillimeve të reja të aktorëve në shoqëri.
Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H. 1, 1017, Tirana | T. +355 4 240 0241 | info@idmalbania.org



të brendshëm përmes veçorive të reja, që u prezantuan në BE bashkë me Direktivat e 5-ta dhe të 6-ta kundër Pastrimit të Parave, me qëllim rritjen e transparencës mbi pronësinë e kompanive dhe investimeve, lehtësimin e punës së FIU-ve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të LKPP.

Metoda të reja komplementare me direktivat janë të nevojshme për të zbuluar pastrimin e parave.

Mekanizmat KPP duhet të përbëhen nga një kuadër rregullator, i bazuar në rreziqet e mundshme, si dhe duhet të ketë një bashkëpunim të rritur midis supervisorëve financiarë dhe jo financiarë, njësisive të inteligjencës financiare (FIU) dhe autoriteteve gjyqësore.

Karel Lannoo

Ekspert i LKPP; CEO i CEPS, Bruksel

Për të zbuluar rastet e dyshimta, mjete bashkëpunimi duhet të zhvillohen në sektorin privat, dhe ndërmjet sektorit publik dhe privat. “Megjithatë, afërsisht 95-98% e aktiviteteve të dyshimta të zbuluara nga sektori privat janë rezultate false; pavarësisht kësaj ato raportohen në

FIU – duke krijuar kështu barrierë në efektiviteten e LKPP. Për të reduktuar diferencat ekzistuese midis FIU-ve për sa i përket organizimit, burimeve dhe stafit, Lannoo rekomandoi zhvillimin e një modeli të vetëm për raportet e transaksioneve të dyshimta midis FIU-ve

Sektori bankar është në vijën e parë të zbulimit të rasteve dhe dërgimit të

informacionit drejt autoriteteve. Kështu, Z. Selami Xhepa, profesor dhe ekspert ekonomie sugjeroi që Regjistri i Pronarëve Përfitues (BO) – i vendosur si pjesë e strukturës së masave të AML-së - duhet të ishte i vendosur nën juridiksionin e Bankës së Shqipërisë. “Në vend që të trajtojë çështjen, vendosja e regjistrimit nën juridiksionin e Drejtorisë Shqiptare të Taksimit zhvlerëson rolin e sektorit bankar. Kjo u theksua veçanërisht gjatë diskutimeve me shoqërinë civile kur ne sugjeruam të ndjekim qasjen e vendeve të tjera ku regjistri është nën juridiksionin e bankave qendrore,” shtoi Xhepa.

Për më tepër, struktura rregulluese duhet të adaptohet për të lejuar organizatat e shoqërisë civile që të kenë një rol proaktiv në monitorim, në mënyrë që gjetjet e tyre të kenë një impakt më të madh. Dr.

Ramandeep Chhina, konsulente ndërkombëtare e AML/CFT (Mbretëri e Bashkuar) njohu tre mënyra sesi academia mund të kontribuojë në përpjekjet e AML-së - së pari, duke drejtuar kërkime ndërdisiplinore mbi AML/CFT. Sipas Dr. Chhina, kërkuesit e kanë aftësinë të identifikojnë çdo çështje madhore ose hendeqe në këtë fushë të cilat duan

performancën më të mirë. Përmes kërkimit, akademikët kanë mundësinë të informojnë vendimmarrësit dhe të informojnë opinionin publik duke drejtuar një analizë të detajuar të përfitimeve dhe kostove të rregullave të LKPP. Ndaj, impakti i kërkimit të tyre është

instrumental në këtë fushë. Ata nuk duhet ta konsiderojnë punën e tyre të mbaruar

pasi publikojnë një artikull, por duhet të fokusohen në matjen e mëtejshme të influencës që kërkimi i tyre ka patur. Së dyti, Dr. Chhina thekson se puna e akademikëve duhet të përqendrohet në shkëmbimin e njohurive, dhe se ata duhet të punojnë duke bashkëpunuar ngushtë me industrinë dhe qeverinë gjithashtu, për të përhapur gjetjet e kërkimit të tyre dhe për të rritur ndërgjegjësimin. Së treti, academia mund të japë një kontribut domethënës duke edukuar brezat e ardhshëm mbi çështjet KPP/KFT. Ajo vuri re mungesën e diplomimeve dhe programeve të trajnimit në AML në Shqipëri dhe theksoi nevojën për të lehtësuar edukimin e avokatëve, noterëve dhe të tjera profesioneve të kësaj fushe, për shkak të spektrit ndërdisiplinor të kësaj teme.

Është e rëndësishme që institucionet e arsimit të lartë të reformohen përmes planeve të tyre të qëndrueshme të veprimit dhe strategjisë, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes akademike, cilësinë e mësimdhënies dhe hulumtimit, për të ofruar hulumtime të thelluara dhe për të patur një brez të ardhshëm profesionistësh të cilët do të jenë interesit të përgatitur dhe të gatshëm për të kontribuar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe krimin financiar.

Ramandeep Chhina
Konsulentë e LKPP/LFT

Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1, 1017, Tirana | T +355 4 240 0241 | info@idmalbania.org

Gazetarët shqiptarë kanë kontribuar në www.idmalbania.org/

thelbësisht në AML duke investiguar

asetet e përfituara përmes korrupsionit dhe krimin të organizuar; nëse harxhimet gjatë fushatës elektorale i përkojnë buxhetit të deklaruar; ose nëse partitë kanë përdorur qarkullime financiare kriminale. Megjithatë, kontributi i tyre ka qenë i limituar. Sipas përfaqësueses së BIRN, Znjsh. Kristina Voko, organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri dhe media nuk kanë folur për krimin e organizuar aq sa ç'duhet. "Kjo bën që media të prodhojë raportim reaktiv, dhe jo pjesë informuese e investiguese."

Fabian Zhilla, ekspert i Global Insight pyeti Znjsh. Voko nëse gazetarëve investigativë u kërkohet trajnim mbi ligjin penal, aksesimin e të dhënave, anonimatin dhe raportimin e çështjeve delikate. Z. Zhilla vuri në pyetje nëse kjo çështje është diskutuar më parë në komunitetin e gazetarisë, dhe nëse ata kanë perceptuar ndonjë mundësi sesi të bashkëpunojnë me akademikët dhe ekspertët për të organizuar trajnime të tilla. Për t'ju përgjigjur, Znjsh. Voko pranoi se ndërsa gazetarët nuk e kanë të gjithë njohurinë e nevojshme, nuk ka një nevojë urgjente për t'i trajnuar ata. Sipas Vokos, mungesa e transparencës institucionale dhe mos interesimi i organizatave të shoqërisë civile në të hetuarit dhe raportuarit krimin të organizuar dhe krimin financiar në mediale shqiptare, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë të konsolidim dhe zhvillojmë në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe veprimeve efektive përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

 /idm_albania  /IDMAlbania

Media duhet t'i japë zë akademisë dhe organizatave, ndërsa këto të fundit duhet të jenë më proaktive në marrëdhënien e tyre me median

Kristina Voko
BIRN Albania

“Duke marrë në konsideratë që gazetarët nuk kanë çfarë të raportojnë, si mund të kuptojmë çfarë nevojash për ndërtimin e kapaciteteve kanë ata?” përfundoi Voko. Nga ana tjetër, Zef Preçi, drejtor i Qendrës Shqiptare për Kërkim Ekonomik (ACER) thekson se media investigative ka bërë një punë thelbësore, por ajo nuk po vijon sepse vullneti politik mungon. Shoqëria civile mund të kontribuojë në këtë aspekt duke drejtuar kërkime të mëtejshme bazuar në gjetjet e gazetarëve investigativë. Z. Preçi gjithashtu e percepton përfshirjen e shoqërisë civile si esenciale në procesin e vlerësimit, analizimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik mbi pastrimin e parave dhe masave të marra nga qeveria – duke vënë në dukje nevojën për studime të detajuara që

adresojnë trajtimin e hershëm të rreziqeve.

Drejtori i ACER theksoi se qeveria shqiptare zakonisht shfaq një qasje emocionale ndaj këtyre çështjeve në vend që të ndjekë një qasje proaktive dhe racionale. Kjo sjell një numër të vogël veprimesh të ndërmarra për të trajtuar pastrimin e parave. Për shembull, Z. Preçi përmendi se gjysma e kompanive që administrojnë burimet natyrore të vendit vijnë nga ishuj të largët, çka përkthehet në më pak taksa të paguara dhe më shumë mundësi për pastrim parash.

Si përfundim, ky Forum pajisi përfaqësuesit e shoqërisë civile, akademinë dhe median me një perspektivë të rinovuar të rolit të tyre në kundërshtimin dhe ndalimin e pastrimit të parave. Ai i prezantoi ata me gjendjen aktuale të aktiviteteve dhe sfidave në luftën ndaj pastrimit të parave në Shqipëri dhe në botë, si dhe i inkurajoi të marrin një rol më aktiv në sektorin e AML-së.



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1, 1017, Tirana | T +355 4 240 0241 | info@idmalbania.org



/ company/idm -albania



<http://www.idmalbania.org/>



/idm_albania



/IDMAbania



Ky event u organizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në kuadër të projektit: "Platforma e Politikave: Ecja përpara në axhendën e integritetit të Shqipërisë në BE" mbështetur nga Fondacioni Hanns-Seidel.

